Përmbledhje e Aktgjykimit në çështjen gjyqësore

***Prokurorja e Specializuar k. Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit* (KSC-BC-2023-12)**

Hyrje dhe akuzat

1. Unë do të shqiptoj përmbledhjen e Aktgjykimit në këtë çështje gjyqësore, e cila do të bëhet e disponueshme për palët në fund të seancës. Ajo që do të lexoj tani është vetëm një përmbledhje e Aktgjykimit autentik me shkrim, që jepet sot në bazë të rregullave 158 dhe 159 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave.
2. **Hashim Thaçi, Bashkim Smakaj, Isni Kilaj, Fadil Fazliu** dhe **Hajredin Kuçi,** akuzohen në këtë çështje gjyqësore për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe rendit publik në kuadër të një gjykimi tjetër në këtë gjykatë, i njohur si *Çështja 6*, në të cilën z. Thaçi ishte i pandehur.
3. Për secilin prej të akuzuarve, me përjashtim të z. Kuçi, janë ngritur akuza mbi bazë të nenit 401(2) të Kodit Penal të Kosovës, për tentativë për pengim, me anë të veprimit të përbashkët të një grupi, të personave zyrtarëve në kryerjen e detyrave zyrtare. Pretendohet se pengimi u tentua të kryhej me mosbindje ndaj urdhrave të gjykatës në Çështjen 6 që u ndalonin të akuzuarve në atë çështje dhe ekipeve të mbrojtjes së tyre kontaktin me dëshmitarë të Prokurorisë, përveçse në përputhje me procedura të përcaktuara.
4. Më konkretisht, pretendohet se z. Thaçi organizoi tri grupe me z. Fazliu, z. Smakaj, dhe z. Kilaj gjatë vizitave të ndryshme të tyre te ai në objektin e paraburgimit të gjykatës këtu në Hagë në korrik, shtator dhe tetor 2023. Secili grup duhej t'i përcillte udhëzime një dëshmitari të Prokurorisë, që do të pengonte aftësinë e Prokurorisë për të përgatitur dhe paraqitur këta dëshmitarë, dhe të gjykatësve të Trupit Gjykues II për të vlerësuar dëshmitë e tyre.

5. Duke qenë se personat të cilët ishin shënjestër e pengimit përfshinin gjykatës dhe prokurorë, paraqitet forma e rëndë e akuzës për vepër penale sipas nenit 401(5) të Kodit Penal të Kosovës, dhe z. Thaçi akuzohet edhe si drejtues ose organizator i secilit grup sipas nenit 401(3).
6. Z. Thaçi pretendohet gjithashtu se u zbuloi vizitorëve të tij informacion konfidencial në lidhje me dëshmitarë, duke shkelur kështu fshehtësinë e procedurës sipas nenit 392(1) të Kodit Penal të Kosovës. Disa nga informacionet që u nxorën kishin të bënin me një dëshmitar të mbrojtur, dëshmitari 4, për të cilën z. Thaçi akuzohet sipas nenit 392(2).
7. Për këto nxjerrje informacioni dhe për arsye se u përpoq të komunikonte me dëshmitarë të Prokurorisë tërthorazi nëpërmjet vizitorëve të tij, z. Thaçi gjithashtu akuzohet për mosbindje ndaj gjykatës, sipas nenit 393.
8. Z. Fazliu, z. Smakaj dhe z. Kilaj akuzohen për pjesëmarrje në veprimin e përbashkët të një grupi për të penguar persona zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, duke u përcjellë udhëzimet e z. Thaçi, dëshmitarëve. Pretendohet gjithashtu se ata ndihmuan ose ranë në marrëveshje për këtë veprim të përbashkët.
9. Ata akuzohen gjithashtu se ndihmuan në mosbindjen ndaj gjykatës të z. Thaçi.
10. Z. Kuçi, i cili në periudhën përkatëse ishte anëtar i ekipit të Mbrojtjes të një të akuzuari tjetër në Çështjen 6, akuzohet për mosbindje ndaj gjykatës sepse: (i) i përcolli një mesazh një dëshmitari të Prokurorisë më 12 prill 2023, në shkelje të urdhrit në fuqi të gjykatës; dhe (ii) u pajtua gjatë vizitës jo të privilegjuar me z. Thaçi në shtator 2023, që t'u përcillte udhëzime tre dëshmitarëve të Prokurorisë.

Historiku procedural dhe provat

11. Gjykatësja e Procedurës Penale ma kaloi dosjen e çështjes më 12 nëntor 2025. Gjykimi filloi me deklaratat hyrëse më 27 shkurt 2026

12. Seancat për paraqitje të provave përfunduan më 5 gusht 2026, pasuar nga deklaratat përmbyllëse më 10, 11 dhe 14 shtator 2026. Dëshmitë dhe provat e nëntë dëshmitarëve u dëgjuan ose u paraqitën gjatë gjykimit, tre nga Prokuroria dhe gjashtë nga Mbrojtja. Kategori të tjera të provave të pranuara përfshinin audioincizime, të dhëna dhe mesazhe të telekomunikimeve, të dhëna nga kompjuteri dhe printeri në objektin e paraburgimit dhe prova dokumentare të tjera. Gjithsej 241 prova materiale të Prokurorisë dhe 163 prova materiale të Mbrojtjes, u pranuan si prova.
13. Provat kryesore kundër të akuzuarve në këtë çështje gjyqësore janë audioincizimet e pesë vizitave midis z. Thaçi dhe të bashkakuzuarve të tij në objektin e paraburgimit. Ato audioincizime u autorizuan nga gjykata. Ato janë thuajse tërësisht në shqipe dhe transkriptimi dhe përkthimi i këtyre audioincizimeve u dorëzua nga Prokuroria, sikurse kërkohej sipas Vendimit për Gjuhën e Punës të lëshuar nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake në dhjetor 2024.
14. Mbrojtja kundërshton fuqimisht mbështetshmërinë në transkriptimin dhe përkthimin e këtyre audioincizimeve. Mbrojtja paraqiti prova nga një eksperte e gjuhësisë forenzike se cilësia e audioincizime ishte aq e ulët sa që Mbrojtja nuk mundi të evidentonte gabime thelbësore në transkriptimin e tyre. Qëndrimi i Mbrojtjes dhe i ekspertit ishte se audioincizimet duhej të transkriptoheshin krejtësisht nga e para nga transkriptues neutralë të cilët duhej të dinin për çështjen vetëm aq sa do t'u jepej konkretisht.
15. Për arsyet e shtjelluara në Aktgjykim, nuk jam bindur se procedura e zgjidhjes së mospajtimeve *inter partes* nuk i dha Mbrojtjes një mundësi të mjaftueshme për të kundërshtuar mbështetshmërinë në transkriptimet dhe përkthimet e Prokurorisë. Në veçanti, nuk pajtohem me mendimin e ekspertes së Mbrojtjes, e cila nuk e flet gjuhën shqipe dhe nuk u ndihmua nga ndonjë folës i gjuhës shqipe gjatë përgatitjes së aktekspertizës së saj, se audioincizimet janë të cilësisë aq të ulët sa Mbrojtja të mos ketë mundur të evidentonte gabime thelbësore dhe

t'ia paraqiste njësisë së pavarur të përkthimit të gjykatës (NJP). As nuk pajtohem se, në qoftë se do ishin paraqitur, NJP-ja nuk do të mund të vlerësonte në mënyrë kompetente çdo pretendim për gabim thelbësor. Kjo është procedurë standarde në këtë gjykatë dhe gjykata të tjera ku trajtohen vëllime të mëdha të audioincizimeve dhe provave të tjera të cilat duhet të përkthehen, dhe nuk u kundërshtua nga Mbrojtja gjatë fazës së procedurës paraprake të procesit. Rrjedhimisht, transkriptet e audioincizimeve, dhe përkthimet përkatëse janë përdorur për t'u mbështetur në to si dokumentim i saktë i asaj që është thënë gjatë atyre vizitave.

16. Mbrojtja ngriti kundërshtime edhe ndaj saktësisë të atribuimit të fjalëve prej Prokurorisë folësve të ndryshëm gjatë atyre vizitave. Atribuimeve të fjalëve prej Prokurorisë nuk iu kushtua peshë provuese në vetvete. Pjesë të mjaftueshme të audioincizimeve mund të atribuoheshin në mënyrë të besueshme nga Gjykatësi i Vetëm për Gjykimin e Çështjes, duke u bazuar vetëm në përmbajtje, për të bërë dallimin midis zërave të folësve gjatë pjesëve të tjera të çdo audioincizimi. Pjesa më e madhe e vizitave të z. Fazliu dhe z. Kuçi përfshiu vetëm dy folës; vizita e z. Kilaj, vetëm tre folës dhe njëra nga dy vizitat e z. Smakaj, gjithashtu vetëm tre folës. Rrjedhimisht, ky verifikim nuk kërkonte identifikim të zërit kundrejt një numri të madh folësish, aq më pak kundrejt popullatës në përgjithësi.

Konstatimet

17. Tani do të diskutoj konstatimet faktike në lidhje me secilën prej vizitave në të cilat mbështeten akuzat, sipas rendit kronologjik, duke filluar me vizitën e z. Fazliu më 2 korrik 2023.

Grupi i Fazliut

18. Z. Thaçi dhe z. Fazliu akuzohen përkatësisht, në Pikat 1 dhe 16, për tentativë të pengimit të detyrave zyrtare sipas nenit 401(2). Z. Thaçi akuzohet gjithashtu në

Pikat 4 dhe 8, për nxjerrje të informacionit konfidencial dhe mosbindje ndaj gjykatës. Z. Fazliu akuzohet në Pikën 17 se ndihmoi z. Thaçi në kryerjen e mosbindjes.

19. Nuk kundërshtohet se z. Fazliu vizitoi z. Thaçi në objektin e paraburgimit më 2 korrik 2023. Z. Thaçi dhe z. Fazliu diskutojnë gjerësisht dëshminë që pritej të jepej shumë shpejt nga dëshmitari i Prokurorisë, Rrustem Mustafa. Z. Thaçi e përshkruan zotin Mustafa si "vendimtar" dhe i jep z. Fazliu një sërë mesazhesh lidhur me formën dhe përmbajtjen e dëshmisë së tij. Këto mesazhe përfshijnë, për shembull: "'"Po shkurt", thuji, "shkurt. Shkurt. Mos filozofo", thuji."'"; "'"Ata", thuji, "kanë besim në ty shumë edhe presin me padurim ti me shku se ti je vendimtar që ja u fut.'"
20. Z. Thaçi më pas jep udhëzime lidhur me dëshminë që pret nga z. Mustafa, përfshirë se "'Përgjegjësi i vetëm i " … 'prej magjistrales'"; se "'"Shefi, a kon DEMAÇI"; se ka qenë i pakënaqur sepse Shtabi i Përgjithshëm "s'më kanë ndihmu ata, se s'kanë ditë me më ndihmu as me lekë, as me logjistikë, as me armatim, jam kon i pakënaqur'"; se "Policinë Ushtarake ky e ka caktu. 'Për SHIK s'ka pas hiç gjatë luftës.'"
21. Z. Thaçi i thotë disa herë z. Fazliu se duhej t'i shkruante këto mesazhe, duke shprehur frikë se z. Fazliu do t'i harronte, duke theksuar se këto nuk ishin thjesht kujtime nga lufta midis shokëve të vjetër, por udhëzime për t'u përcjellë më tutje.
22. Z. Thaçi e paralajmëron z. Fazliu se "ata e vesin […] 'A të ka thirr kush?'". Fjala "ata" është vetëm një nga shumë shembujt ku z. Thaçi u referohet zyrtarëve të Prokurorisë dhe detyrave të tyre, që tregon se ai ishte i vetëdijshëm se si udhëzimet e tij do të ndikonin dhe pengonin detyrat zyrtare të personave zyrtarë përgjegjës për paraqitje dhe vlerësim të dëshmitarëve kundër tij në *Çështjen 6*.
23. Kur z. Thaçi e paralajmëron z. Fazliu për të mos rrezikuar veten, z. Fazliu propozon që djali i tij, Fahriu të kontaktonte z. Mustafa me pretekstin për të

diskutuar një proces pajtimi lidhur me një incident të gjuajtjes me armë zjarri, ku ishin përfshirë shokë të familjeve Fazliu dhe Mustafa. Procesi i pajtimit mund të ketë qenë fare mirë një prej qëllimeve të takimit midis z. Fazliu, Fahriut, dhe z. Mustafa më 29 qershor 2023, përpara vizitës së z Fazliu. Megjithatë, përshkrimi nga z. Fazliu për z. Thaçi i atij takimi tregon se ata diskutuan gjithashtu dëshminë që pritej të jepte z. Mustafa në gjykatë, dhe në këtë kontekst z. Mustafa ishte i gatshëm të pranonte mesazhe nga z. Thaçi. Preteksti i procesit të pajtimit mbështetet edhe nga fakti që mesazhet që z. Thaçi i përcolli z. Fazliu gjatë vizitës së 2 korrikut nuk kanë të bëjnë me proces pajtimi, por vetëm me dëshminë që pritej të jepte z. Mustafa.

24. Të nesërmen, pasi z. Fazliu ishte kthyer në Prishtinë, dhe pikërisht ashtu siç diskutuan z. Thaçi dhe z. Fazliu një ditë më parë, Fahri Fazliu kontaktoi me mesazh telefonik z. Mustafa. Mesazhet tregojnë që Fahri Fazliu organizoi një takim midis tij dhe babait të tij me z. Mustafa dhe që më pas mbërritën në vendtakimin e tyre. Është shqyrtuar me kujdes. sikurse shtjellohet në Aktgjykim, nëse Fahri Fazliu organizoi takimin duke e ditur qëllimin e babait të tij, dhe nëse synonte të merrte pjesë në veprim pengues të përbashkët. Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat, sikurse paraqitet më gjerësisht në Aktgjykim, mund të nxirret me siguri përfundimi se Fahri Fazliu ishte i vetëdijshëm për qëllimin.
25. Forma e pengimit që pretendohet në këtë çështje gjyqësore nuk është pengim faktik, por tentativë për pengim. Tentativa ndodh, sipas nenit 28 të Kodit Penal të Kosovës, kur një person ndërmerr veprime për kryerjen e një vepre penale. Ky standard u përmbush në momentin që Fahri Fazliu kontaktoi z. Mustafa më 3 korrik 2023 dhe u tejkalua konsiderueshëm kur, sikurse vërtetohet nga provat rrethanore, udhëzimet e z. Thaçi iu përcollën z. Mustafa gjatë atij takimi.
26. Jam bindur se tentativa për pengim kishte në shënjestër prokurorë dhe gjykatës të përfshirë në procesin e *Çështjes 6*, sipas nenit 401(5), dhe se z. Thaçi ishte drejtues dhe organizator i grupit sipas nenit 401(3).

27. Rrjedhimisht, konstatohet jashtë dyshimit të arsyeshëm se z. Thaçi dhe z. Fazliu kanë tentuar me anë të veprimit të përbashkët të pengojnë detyrat zyrtare të personave zyrtarë, sikurse paraqitet përkatësisht në Pikat 1 dhe 16. Z. Thaçi kreu gjithashtu mosbindje ndaj gjykatës për këtë sjellje sikurse akuzohet në Pikën 8 dhe konstatohet se z. Fazliu ka ndihmuar mosbindjen e paraqitur në Pikën 17.
28. Gjatë vizitës së 2 korrikut, z. Thaçi zbuloi gjithashtu informacion konfidencial në lidhje me disa dëshmitarë të Prokurorisë në *Çështjen 6*. Mbi bazë të këtyre nxjerrjeve të informacionit, konstatoj jashtë dyshimit të arsyeshëm se z. Thaçi shkeli fshehtësinë e procedurës dhe kreu mosbindje ndaj gjykatës sikurse akuzohet në Pikat 4 dhe 8.
29. Megjithatë, nuk jam bindur se z. Fazliu ndihmoi në këto nxjerrje të informacionit, që u realizuan në momentin që ndodhën.

<u>Grupi i Smakajt</u>

30. Tani do të trajtoj vizitat e z. Smakaj me z. Thaçi më 9 shtator dhe 7 tetor 2023.
31. Z. Thaçi dhe z. Smakaj akuzohen përkatësisht në Pikat 2 dhe 12, për tentativë për pengim të detyrave zyrtare me anë të veprimit të përbashkët sipas nenit 401(2). Z, Thaçi gjithashtu akuzohet në Pikat 5 dhe 10 për shkelje të fshehtësisë së procedurës dhe mosbindje ndaj gjykatës përmes zbulimit të informacionit konfidencial dhe për shkelje të ndalimit të kontaktit me dëshmitarë të Prokurorisë. Z. Smakaj akuzohet në Pikën 13 se ndihmoi z. Thaçi në mosbindje ndaj gjykatës.
32. Z. Thaçi përmend dëshmitarin e Prokurorisë në Çështjen 6, Bislim Zyrapi, me emër disa herë gjatë vizitës së parë, duke kaluar nga shprehja e shpresës se si do të dëshmonte ai, në dhënie të udhëzimeve të rëndësishme që duhej t'i përcilleshin atij. Për shembull, z. Thaçi thotë:

> "mos e përzi", çfarë, çfarë Qeverie e Përkohshme?! Ambicie! […] Po çfarë Shërbimi Inteligjent, bre?! Me e hek […] Tregohet ambicie po kanë pas

> zonat në komandim, "komandantët, komandantët, komandantët, komandantët". […] "Nëntorin hiqe pa shtab, 'janë dalë jashtë'". Q'ashtu janë edhe letrat! […]dhe ""Thjeshtëzoje", thuji, "mos e ngatërro. Mos e ngatërro, o burrë. […] mos fol qysh duhet të duhej, mos fol qysh u bo ushtria e Bosnjës dhe e Jugosllavisë në letra". Se ky ka teori shumë […] Thuji, "Ti s'ke mujt ti krejt katunarinë janë kon vullnetarë […]".

33. Pjesë nga vizita e 9 shtatorit tregojnë se z. Thaçi pret që këto udhëzime të përcillen nga z. Smakaj. Sidoqoftë, vetëm audioincizimet, duke marrë parasysh masën që shkëmbimet relevante janë shënuar "e pakuptueshme", janë të pamjaftueshme për të arritur në përfundimin se z. Smakaj u pajtua ta bënte këtë gjatë asaj vizite.

34. Kur z. Smakaj u kthye më 7 tetor, këtë herë me vetëm një vizitor tjetër, ai bën të ditur se kishte kontaktuar me z. Zyrapi. Ai raporton se z. Zyrapi kërkonte shpjegime të mëtejshme lidhur me disa aspekte të dëshmisë së tij. Kjo më tej çon në një diskutim të detajuar të udhëzimeve që duhej t'i përcilleshin z. Zyrapi ku duket se z. Thaçi dhe z. Smakaj i referohen një dokumenti me shkrim., Bazuar në atë që mund të dëgjohet, është e qartë se z. Smakaj, ose z. Behrami, kishin ndër mend ta merrnin atë dokument me vete jashtë objektit të paraburgimit.
35. Më 30 tetor 2023, në banesën e z. Smakaj u krye një kontroll gjatë të cilit u gjet një dokument që, për nga përmbajtja, duket se ka një sërë udhëzimesh për z. Zyrapi. Për arsye të trajtuara më gjerësisht në Aktgjykim, Prokuroria ka vërtetuar në mënyrë të mjaftueshme se dokumenti u sekuestrua në banesën e z. Smakaj.
36. Provat digjitale nga kompjuteri i vënë në dispozicion të z. Thaçi në qelinë e tij në objektin e paraburgimit, vërtetojnë se ai ruajti në formë digjitale një dokument identik me atë të gjetur në vendbanimin e z. Smakaj dy ditë para vizitës së dytë të z. Smakaj.. Bazuar në provat digjitale dhe rrethanore, të shtjelluara më hollësisht në Aktgjykim, deduksioni i vetëm i arsyeshëm është

se dokumenti i sekuestruar në banesën e z. Smakaj u printua nga z. Thaçi në objektin e paraburgimit, më 7 tetor 2023.

37. Të dhënat telefonike tregojnë se z. Smakaj dhe z. Zyrapi kanë qenë në kontakt midis dy vizitave, si dhe pak kohë pas vizitës së 7 tetorit. Bazuar në provat rrethanore dhe të telekomunikimit, jam bindur se z. Smakaj u takua me z. Zyrapi më 24 tetor 2023 dhe i përcolli atij udhëzime lidhur me dëshminë e ardhshme të tij, ashtu siç ishte diskutuar gjerësisht me z. Thaçi gjatë vizitës së 7 tetorit.
38. Sa i përket asaj nëse ndonjë person i tretë u përfshi në veprimin e përbashkët pengues çka është kriter i nenit 401(2), z. Behrami i cili e vizitoi z. Thaçi bashkë me z. Smakaj në të dyja rastet, flet qëllimisht për të mbuluar një bisedë pështpëritëse që po zhvillohej midis z. Thaçi dhe z. Smakaj gjatë vizitës së 9 shtatorit, në një mënyrë që tregon një përpjekje të vetëdijshme për të fshehur çka po thuhej. Ai gjithashtu nxiti marrjen e dokumentit nga objekti i paraburgimit gjatë vizitës së 7 tetorit. Këto veprime janë të mjaftueshme për ta cilësuar atë si pjesëmarrës në veprimin pengues.
39. Gjithashtu jam bindur se tentativa për pengim kishte në shënjestër prokurorët dhe gjykatësit e përfshirë në procesin e *Çështjes 6*, e u krye sipas formës së rëndë të veprës penale të parashikuar në nenin 401(5), dhe se z. Thaçi ishte drejtuesi dhe organizatori i grupit sipas nenit 401(3).
40. Rrjedhimisht, konstatoj se për z. Thaçi dhe z. Smakaj është provuar jashtë dyshimit të arsyeshëm se me anë të veprimit të përbashkët, kanë tentuar të pengojnë persona zyrtarë në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare, sikurse akuzohen në Pikat 2 dhe 12 të Aktakuzës. Me këto veprime, z. Thaçi kreu mosbindje ndaj gjykatës sipas Pikës 10 të Aktakuzës dhe z. Smakaj ndihmoi në mosbindje sipas Pikës 13 të Aktakuzës.
41. Z. Thaçi zbuloi gjithashtu informacion konfidencial në lidhje me të paktën pesë dëshmitarë të tjerë të Prokurorisë, përveç z. Zyrapi, gjatë vizitave të 9 shtatorit dhe 7 tetorit, duke shkelur fshehtësinë e procedurës sipas nenit 392, sikurse

akuzohet në Pikën 5 të Aktakuzës, dhe duke kryer mosbindje ndaj gjykatës sikurse akuzohet në Pikën 10 të Aktakuzës.

42. Megjithatë, nuk jam bindur se z. Smakaj ka ndihmuar në këto nxjerrje informacioni, çka u realizua në momentin që ndodhën.

Grupi i Kilajt

43. Z. Kilaj e vizitoi zotin Thaçi në objektin e paraburgimit më 6 tetor 2023, bashkë me z. Kryeziu. Z. Thaçi i dha udhëzime të hollësishme z. Kilaj se si duhej të dëshmonte dëshmitari 4, dëshmitar i mbrojtur i Prokurorisë. Z. Kilaj duket se u pajtua gjatë asaj vizite se do t'ia përcillte këto udhëzime dëshmitarit 4.
44. Z, Thaçi përmend dy deklarata të mëparshme të dëshmitarit 4 gjatë vizitës së 6 tetorit në mënyrë të tillë që sugjeron se dy deklaratat ishin para tij dhe zotit Kilaj kur ata diskutuan udhëzimet. Këto dy deklarata të mëparshme të dëshmitarit 4 u sekuestruan gjatë një kontrolli të shtëpisë së z .Kilaj në Prishtinë më 2 nëntor 2023. Provat digjitale tregojnë se z. Thaçi i rishikoi këto dokumente në kompjuterin e tij pak para vizitës së z. Kilaj, dhe i përgatiti për printim. Nuk ka asnjë dyshim të arsyeshëm, duke marrë parasysh të gjitha provat digjitale dhe rrethanore, si dhe provat e drejtpërdrejta nga audioincizimi, se z. Thaçi ia dha këto deklarata të mëparshme të dëshmitarit 4, zotit Kilaj gjatë vizitës së 6 tetorit dhe se z. Kilaj i mori ato nga objekti i paraburgimit.
45. Megjithatë, provat nuk vërtetojnë se vizitori i tretë gjatë vizitës së 6 tetorit, z. Kryeziu, mori pjesë në veprimin e përbashkët pengues. Z. Kryeziu nuk duket se ndërhyn duke folur në bisedat midis z. Thaçi dhe z. Kilaj për të fshehur përmbajtjen e tyre, e as nxit veprime pengues, as nuk luan kurrfarë roli. Nuk ka asnjë provë se z. Thaçi ose z. Kilaj prisnin që z. Kryeziu të luante një rol të tillë qoftë gjatë, apo pas vizitës së 6 tetorit.
46. Gjithashtu, provat nuk tregojnë se z. Kilaj ndërmori ndonjë hap të mëtejshëm pas vizitës së 6 tetorit për të kontaktuar dëshmitarin 4.

47. Në këto rrethana, nuk jam bindur se është përmbushur kriteri për formën e tentativës së kryerjes së veprës penale, as se janë përmbushur kriteret që lidhen me marrëveshjen ose ndihmën. Rrjedhimisht, nuk konstatoj se z. Thaçi dhe z. Kilaj tentuan, nëpërmjet veprimit të përbashkët, të pengonin persona zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, sikurse akuzohen në Pikat 3 dhe 14 të Aktakuzës.
48. Megjithatë, z. Thaçi u zbuloi informacion konfidencial për gjashtë dëshmitarë të Prokurorisë zotit Kilaj dhe zotit Kryeziu gjatë vizitës së 6 tetorit, përfshirë identitetin e dëshmitarit 4 si dëshmitar i mbrojtur i Prokurorisë, si dhe deklaratat konfidenciale të dhëna më parë prej tij.
49. Për këto veprime, konstatoj, jashtë dyshimit të arsyeshëm, se z. Thaçi shkeli fshehtësinë e procedurës dhe kreu mosbindje ndaj gjykatës, sikurse akuzohet në Pikat 6, 7 dhe 11 të Aktakuzës.
50. Megjithatë, nuk jam bindur se z. Kilaj ndihmoi në këto nxjerrje informacioni, që u realizuan kur ndodhën.

Z. Kuçi

51. Ndaj z. Kuçi janë ngritur dy akuza për mosbindje ndaj gjykatës; e para lidhet me dërgimin e një mesazhi zotit Mustafa, pas paraqitjes së këtij të fundit në një program televiziv ku komentoi në lidhje me themelësinë e provave kundër z. Thaçi në *Çështjen 6*. Në mesazh thuhet, "Shoq, të përgëzo[j] për profesionalizëm, për idetë e qarta për vendin dhe luftën dhe për guximin. Të lumtë". Sado i pafajshëm që mund të duket ky mesazh, z. Kuçi ishte në atë kohë anëtar i njërit prej ekipeve të tjera të Mbrojtjes në *Çështjen 6*, dhe, rrjedhimisht, e kishte të ndaluar, me urdhër gjyqësor, të kontaktonte dëshmitarë të Prokurorisë. Ky mesazh nuk mund të ishte dërguar – veçanërisht duke pasur parasysh përmbajtjen e programit televiziv – pa e ditur z. Kuçi se po kontaktonte një dëshmitar të Prokurorisë. Gjithashtu, kjo nuk mund të

konsiderohet si një veprim me pak rëndësi në kuptim të nenit 11 të Kodit Penal të Kosovës, i cili, sidoqoftë, vlerësohet se nuk është i zbatueshëm në këtë rast.

52. Për këtë veprim, konstatoj jashtë dyshimit të arsyeshëm, se z. Kuçi kreu mosbindje ndaj gjykatës sikurse akuzohet në Pikën 19 të Aktakuzës..
53. Z. Kuçi dhe z. Thaçi akuzohen gjithashtu për mosbindje ndaj gjykatës, përkatësisht sipas Pikave 9 dhe 18 të Aktakuzës, për rënie në marrëveshje që z. Kuçi të kontaktonte tre dëshmitarë të Prokurorisë në Çështjen 6 në emër të z. Thaçi, lidhur me çfarë duhej të thoshte secili në dëshmitë e tyre.
54. Megjithatë, provat nuk vërtetojnë se u ndërmor ndonjë veprim thelbësor drejt kryerjes së veprës penale. Rrjedhimisht, nuk jam bindur jashtë dyshimit të arsyeshëm se z. Kuçi e kreu këtë vepër penale, për të cilën akuzohet në Pikën 18 të Aktakuzës, apo se z. Thaçi e kreu këtë vepër penale, për të cilën akuzohet në Pikën 9 të Aktakuzës.

Dënimi

55. Tani do të trajtoj dënimin.
56. Shkallëzimi i dënimit për tentativën për pengim me anë të veprimit të përbashkët është nga një deri në pesë vjet burgim, sipas nenit 401(3) dhe 401(5) të Kodit Penal të Kosovës; deri në tre vjet burgim për zbulim të informacionit për një dëshmitar të mbrojtur, sipas nenit 392(2); deri në një vit burgim për zbulim të informacioneve të tjera konfidenciale, sipas nenit 392(1); dhe deri në gjashtë muaj burgim për mosbindje ndaj gjykatës, sipas nenit 393(1).
57. Këto shkallëzime dënimesh, veçanërisht për format e rënda të veprës penale të parashikuara në nenin 401(3) dhe 401(5), dëshmojnë për peshën thelbësore të veprave penale të kryera. Pengimi i kryerjes së detyrave zyrtare që lidhen me gjykime në kryerje e sipër, përbën sulm ndaj integritetit të sistemit gjyqësor, që shërben si themel për sundimin e ligjit.
58. Faktorët e renditur në nenet 69, 70 dhe 71 të Kodit Penal të Kosovës janë marrë parasysh dhe janë peshuar gjatë përcaktimit të dënimit të përshtatshëm. Në

fund të fundit, objektivi kryesor është shqiptimi i një dënimi të njësuar, proporcional me peshën e veprave penale të kryera nga personi i shpallur fajtor. Ndonëse është shqyrtuar me kujdes praktika e dhënies së dënimeve në gjykatat e Kosovës për veprat penale sipas nenit 401, shumë prej këtyre rasteve përfshijnë rrethana krejtësisht të ndryshme nga kjo çështje gjyqësore.

59. Faktorët që janë marrë parasysh për përcaktimin e dënimeve të përshtatshme në çështjen aktuale, të cilët janë diferencuar në mënyrë më të plotë në funksion të rolit të secilit të akuzuar, të përcaktuar në Aktgjykim, janë: fakti se pengimi i personave zyrtarë synohej të realizohej përmes ndërhyrjes te dëshmitarët e Prokurorisë; karakteri gjithëpërfshirës i disa prej udhëzimeve të përcjella, si dhe shkalla e planifikimit dhe e paramendimit që lidhej me këto udhëzime; rreziqet konkrete që lindën si rezultat i zbulimit të informacionit të dëshmitarit 4, përfshirë zbulimin në formë të shkruar të informacionit; mungesa e kërcënimeve, shtrëngimit, ofrimit të përfitimeve apo e frikësimit; dhe shtrirja relativisht e kufizuar e veprimtarisë kriminale. Dënimet e dhëna, për arsyet që paraqiten më hollësisht në Aktgjykim, nuk do të kryhen njëkohësisht me asnjë dënim të shqiptuar nga ndonjë gjykatë tjetër e Kosovës për akuza që nuk kanë lidhje, përfshirë ato të *Çështjes 6*, dhe nuk do të llogaritet koha e kaluar në paraburgim në bazë të fletarrestimit të lëshuar lidhur me akuza të tjera.

<u>Vendim</u>

60. Tani do të lexoj vendimin dhe dënimet përkatëse sipas personit, ku secili dënim shpallet në emër të popullit të Kosovës, në përputhje me rregullën 159(2) të Rregullores.

61. Z. Hashim Thaçi, ju lutem ngrihuni në këmbë. Unë ju shpall:

a. **fajtor** për tentativë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare me anë të veprimit të përbashkët, sipas nenit 401(2), (3) dhe (5), sipas **Pikave 1** dhe **2** të Aktakuzës;
b. **fajtor** për shkelje të fshehtësisë së procedurës, sipas nenit 392(1) dhe (2), sipas P**ikave 4, 5, 6** dhe **7** të Aktakuzës; dhe
c. **fajtor** për mosbindje ndaj gjykatës, sipas nenit 393(1), sipas **Pikave 8, 10** dhe **11** të Aktakuzës.

62. Ju shpall **të pafajshëm** për tentativë për pengim të personave zyrtarë, sipas Pikës 3 të Aktakuzës; dhe të pafajshëm për mosbindje ndaj gjykatës, sipas **Pikës 9** të Aktakuzës.

63. Për veprat penale, për të cilat u shpallët fajtor, dënoheni me dënim të njësuar prej 17 **muajsh** burgim.

64. Z. Thaçi, mund të uleni.

65. Z. Bashkim Smakaj, ju lutem ngrihuni në këmbë. Unë ju shpall:

a. **fajtor** për tentativë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare me anë të veprimit të përbashkët, sipas nenit 401(2) dhe (5), dhe sipas **Pikës 12** të Aktakuzës; dhe
b. **fajtor** për mosbindje ndaj gjykatës, sipas nenit 393 dhe sipas **Pikës 13** të Aktakuzës.

66. Për këto vepra penale, ju dënoheni me dënim të njësuar prej 12 **muajsh** burgim. Meqenëse, tashmë keni kaluar në paraburgim një periudhë më të gjatë se kjo, në bazë të fletarrestimit kundër jush në këtë çështje gjyqësore, dënimi juaj konsiderohet i shlyer dhe ju do të liroheni në përfundim të kësaj seance. Çfarëdo kushtesh lirimi të vendosura më parë në këtë çështje gjyqësore,

pushojnë së qeni në fuqi dhe Zyra Administrative do të marrë masa për kthimin e shpejtë të garancisë suaj financiare.

67. Z. Smakaj, mund të uleni.

68. Z. Kilaj, ju lutem ngrihuni në këmbë. Unë ju shpall:

    a. të pafajshëm për tentativë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare me anë të veprimit të përbashkët sipas nenit 401(2) dhe (5), sipas Pikës 14 të Aktakuzës; dhe
    b. të pafajshëm për mosbindje ndaj gjykatës, sipas Pikës 15 të Aktakuzës.

69. Ju do të liroheni në përfundim të kësaj seance dhe çfarëdo kushtesh për lirim pushojnë së qeni në fuqi. Zyra Administrative do të marrë masa për kthimin e shpejtë të garancisë suaj financiare

70. Z. Fadil Fazliu, ju lutem ngrihuni në këmbë. Unë ju shpall:

    a. fajtor për tentativë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare me anë të veprimit të përbashkët, sipas nenit 401(2) dhe (5), sipas Pikës 16 të Aktakuzës; dhe
    b. fajtor për mosbindje ndaj gjykatës, sipas nenit 393 dhe sipas Pikës 17 të Aktakuzës.

71. Për këto vepra penale, ju dënoheni me dënim të njësuar prej 12 **muajsh** burgim. Meqenëse, tashmë keni kaluar në paraburgim një periudhë më të gjatë se kjo, në bazë të fletarrestimit në këtë çështje gjyqësore, dënimi juaj konsiderohet i shlyer dhe ju do të liroheni në përfundim të kësaj seance. Çfarëdo kushtesh të mëparshme për lirim në këtë çështje gjyqësore, pushojnë së qeni në fuqi dhe

Zyra Administrative do të marrë masa për kthimin e shpejtë të garancisë suaj financiare

72. Z. Fazliu, mund të uleni.

73. Z. Kuçi, ju lutem ngrihuni në këmbë. Unë ju shpall:

    a. të pafajshëm për mosbindje ndaj gjykatës, sipas nenit 393 dhe sipas Pikës 18 të Aktakuzës; dhe
    b. fajtor për mosbindje ndaj gjykatës sipas nenit 393 dhe sipas Pikës 19 të Aktakuzës.

74. Për këtë vepër penale ju shqiptohet dënim me kusht me burgim njëmujor që do të konsiderohet i kryer pas një viti, në qoftë se nuk kryeni gjatë asaj periudhe asnjë vepër tjetër penale sipas Kodit Penal të Kosovës. Çfarëdo kushtesh të mëparshme në këtë çështje gjyqësore, pushojnë së qeni në fuqi.
75. Tani, Aktgjykimin me shkrim Zyra Administrative do t'u shpërndajë palëve në formë elektronike dhe kopje të legalizuara të versionit të tij në anglishte do t'u jepen të akuzuarve. Meqenëse Aktgjykimi është konfidencial, kopjet që do t'u jepen z. Smakaj, z. Kilaj, z. Fazliu dhe z. Kuçi, do të mbahen prej mbrojtësve të tyre përkatës. Do të merren masa që ata të mund të shohin Aktgjykimin brenda ndërtesës së DHSK-së pas kësaj seance. Versioni në gjuhën shqipe do të jepet sapo të jetë gati. Versioni i redaktuar publik i Aktgjykimit do të lëshohet më vonë.
76. Seanca mbyllet.